

## 4.7 KËRKIMI ME LISTËN E NUMRAVE IDENTIFIKUES TË REGJISTRIMEVE

Në mënyrën e specializuar të kërkimit mund të përdorni listat e numrave identifikues, të cilat i keni ruajtur paraprakisht për kërkim të mëtejshëm.


### *Procedura*

1. Klikoni butonin **Lista ID**.  
Hapet dritarja **Lista ID**.
2. Shënoni numrat identifikues (ID-të), të cilët mes vete i ndani me një rresht të ri, presje, hapësirë ose me tab.



Shënim:

*Në listë mund të vendosni deri në 25.000 ID. Nëse vendosni më shumë, gjatë kërkimit respektohen vetë 25.000 ID-të e para.*

3. Klikoni butonin **Në rregull**.  
Në buton shfaqet numri i ID-ve të shtuara.
4. Mund të vendosni edhe pyetjet shitesë për kërkim (shih kap. 4.2–4.3).
5. Klikoni butonin **Gjej**.  
Ekzekutohet kërkimi në bazën e përzgjedhur të të dhënave, mirëpo vetëm për regjistrimet, numrat identifikues të të cilëve janë vendosur në listë. Shfaqen rezultatet e kërkimit që u përshtaten pyetjeve për kërkim.
6. Listën e numrave identifikues mund ta fshini duke klikuar në butonin  ose butonin **Kërkimi i ri**.